

VENDIM
Nr. 810, datë 21.11.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
OBJEKTET E INVESTIMEVE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË, NË KUADËR TË FONDIT TË
ZHVILLIMIT TË RAJONEVE, PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e njësive të qeverisjeve vendore (bashki/komuna), si autoritete kontraktore, të përfundojnë, brenda datës 15.12.2012, realizimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve të shërbimit parësor, me fondet e zhvillimit të rajoneve, të miratuara në buxhetin e vitit 2012, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihen dhe lidhja e kontratave, ekzekutimi i punimeve dhe financimi i vlerës së akorduar për vitin 2012.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, njësitë e qeverisjeve vendore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha